



Znj. Helda Mitre është diplomuar në Fakultetin e Shkencave Natyrore për Informatikë në vitin 2005. Gëzon një ekspertizë të gjatë në fushën e infrastrukturës teknologjike, sistemeve për implementimin e metodave inovative për mbledhjen dhe monitorimin e të dhënave, manaxhimit të cilësisë dhe metadatave, si dhe aplikimit të metodologjive të ndryshme për zhvillimin e aktiviteteve statistikore.

Prej vitit 2005, ka ushtruar detyra të ndryshme në Institutin e Statistikave, e angazhuar në nivele të ndryshme, fillimisht si Specialiste në Sektorin e Zhvillimit të Programeve Kompjuterike, më pas si Përgjegjëse i këtij sektori, për të vazhduar më tej në pozicion e Drejtorit të Drejtorisë të Teknologjisë së Informacionit.

Znj. Mitre ka kontribuar si autore apo bashkëautore në studime të rëndësishme në fushat e statistikës dhe ekonomisë si dhe është anëtare e bordit editorial të Revistës Shkencore KËRKIMI dhe Revistës Informative INFOSTAT.

Nga Prilli i vitit 2019, mban detyrën e Drejtorit të Drejtorisë së Përgjithshme të Teknologjisë së Informacionit dhe Mbledhjes së të Dhënave.